



BASHKIA  
SHKODËR



# UDHËZUES I APLIKIMIT

‘Për implementimin e skemës së granteve’


Krijimi i një skemë garancie  
për bizneset inovative për të rinjtë,  
nëpërmjet mbështetjes financiare me grante.

*Shkodër, Tetor 2024*

# PËRMBAJTJA:

1. Hyrje
2. Qëllimi dhe Objektivat
3. Përfitimet e një biznesi Eko-Inovativ
4. Përfituesit e skemës

# UDHËZUESI I APLIKIMIT

1. Çfarë është granti për bizneset inovative?
  2. Mbështetja financiare
  3. Aplikantët e pranueshëm
  4. Likuidimi i Shpenzimeve
  5. Shpenzimet që mund të mbulohen nga skema
  6. Mbulimi gjeografik
  7. Strukturat e skemës së grantit dhe detyrat e tyre
  8. Mënyra e procedimit të skemës së grantit
- 

## 1. Hyrje

Zbatimi i politikave vendore për mbështetjen dhe rritjen e kapaciteteve të bizneseve përbën një sfidë, prandaj është e rëndësishme të përqendrohemi në inkurajimin e iniciativave që nxisin dhe zhvillojnë bizneset e reja dhe ekzistuese. Një gjë e tillë është thelbësore për ndërtimin e një ekonomie të fortë, konkurruese dhe inovative. Kur këto iniciativa ndërthurin konceptet e ekonomisë, ekologjisë dhe inovacionit, ato krijojnë një model të ri zhvillimi ekonomik që është në gjendje të përballojë sfidat e zhvillimit pa dëmtonuar mjedisin. Një qasje e tillë quhet eko-inovacion dhe është një term i ri botëror.

Eko-inovacioni i referohet të gjitha formave të inovacionit teknologjik dhe jo vetëm, produkteve dhe shërbimeve të reja që krijohen me qëllim zhvillimin e mundësive të reja të bërit biznes, duke parandaluar ose zvogëluar ndikimet negative në mjedis, ose duke optimizuar shfrytëzimin e burimeve natyrore. Zbatimi i një procesi të tillë krijon avantazhe konkurruese për biznesin, pasi është në gjendje t'i japë zgjidhje afatgjatë ndryshimit të tendencave të reja të tregut.

Qëllimi ynë është të promovojmë një model të qëndrueshëm të zhvillimit ekonomik, miqësor ndaj mjedisit, për t'i dhënë proceseve, produkteve dhe shërbimeve të NVM-ve një vlerë të shtuar në treg. Një proces i tillë promovon qëndrueshmërinë gjatë gjithë ciklit jetësor të një produkti, duke filluar nga sigurimi i lëndës së parë, prodhimin, shërbimin, shpërndarjen, përdorimin e produktit dhe asgjësimin e tij. Kjo qasje e re menaxhimi çon në zgjerimin e rrjetit të bashkëpunimit dhe tërheqjen e investimeve të reja për biznesin dhe njëkohësisht ndikon në uljen e kostove, reduktimin e ndotjes në mjedis krahasuar me alternativat ekzistuese.

Ndryshimet klimatike janë tashmë çështje të interesit global. Çështjet e cilësisë së ajrit, ujit, zhurmave në mjedis apo menaxhimi i mbeturinave që vijnë nga aktivitetet e prodhimit ekonomik, kërkojnë vëmendje të shtuar. Për të adresuar këto sfida mjedisore, shumica e vendeve evropiane dhe më gjerë, po promovojnë politikat e ekonomisë së gjelbër, si instrumentin kryesor për të parandaluar ndikim negativ në mjedis. Kjo në përputhje me Agjendën 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Në këtë kontekst, Bashkia Shkodër synon të forcojë bashkëpunimin me sektorin privat, në koordinim të ngushtë me institucionet e tjera përgjegjëse për të ofruar një qasje të qëndrueshme dhe efektive, e orientuar drejt zhvillimit ekonomik dhe e bazuar në një skemë granti për financimin e të rinjve që kanë një ide apo kanë një biznes ekzistues të vogël ose të mesëm dhe janë të regjistruar në Bashkinë Shkodër. Kjo, jo vetëm si një detyrim ligjor, por edhe si një praktikë e mirë, të cilën parashikon ta zbatojë në vitet në vazhdim për disa sektorë të ekonomisë.

Skema e Grantit do të zbatohet përmes një procesi të bazuar në konkurrencë, me qëllim që të sigurohet kthimi më i lartë i mundshëm i investimit. Ky proces konkurrues do të bëjë të mundur përzgjedhjen e projekteve më të mira dhe më të qëndrueshme, duke garantuar përdorimin efikas të fondeve dhe maksimizimin e përfitimeve për bizneset dhe komunitetin.

## 2. Qëllimi dhe Objektiva

### 2.1 Çfarë është Ekonomia “Eko Inovative”?

Eko-inovacioni është zhvillimi dhe aplikimi i një modeli biznesi që përfshin një strategji të re, e cila integron qëndrueshmërinë në të gjithë veprimtarinë e biznesit, duke u bazuar në ciklin jetësor të produkteve, me të gjithë partnerët dhe në të gjithë zinxhirin e vlerës. Ai ofron zgjidhje të reja në lidhje me produktet (mallrat/shërbimet), proceset, aksesin në treg dhe strukturën organizative.

Kjo lloj ekonomie fokusohet në zhvillimin e produkteve, shërbimeve dhe proceseve që janë ekologjikisht të qëndrueshme dhe krijojnë një vlerë të shtuar për konsumatorët.

### 2.2 Çfarë është biznesi “Eko Inovativ”?

Një biznes “Eko inovativ” apo biznesi me elementin e “Gjelbër” është një biznes i qëndrueshëm, një sipërmarrje që ka ndikim minimal negativ, ose ndikim potencialisht pozitiv në mjedisin global ose lokal, komunitetin, shoqërinë dhe ekonominë. "**Veprimtari e gjelbër**" është një term sa i ri aq shumë i përdorur në ditët e sotme, do të thotë të ndjekësh njohuri dhe praktika që mund të çojnë në vendime dhe mënyra të jetesës më miqësore ndaj mjedisit dhe ekologjikisht të përgjegjshme, të cilat mund të ndihmojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe të ruajnë burimet e tij natyrore për gjeneratat e tanishme dhe të ardhshme.

Koncepti “**Biznes Eko-inovativ**” përbëhet nga dy elemente "**biznesi**" dhe "**eko-inovacioni**". Si të gjithë bizneset e tjera, edhe ky tip biznesi krijon të ardhura, por "Eko-inovativ" do të thotë ta bësh këtë, ndërkohë që shfrytëzon në mënyrë të qëndrueshme mundësitë që ofron natyra pa dëmtuar mjedisin dhe duke futur brenda tij procese inovative.

Bizneset Eko-Inovative në terminologjinë e përditshme janë biznesi i gjelbër, i cili përcaktohet nga dy këndvështrime: njëra lidhet me ofrimin e produkteve ose shërbimeve të gjelbërta, ndërsa tjetra lidhet me procesin e veprimtarisë ekonomike. Kjo do të thotë që sipërmarrësit mund të hyjnë në sektorin e sipërpërmendur të biznesit duke ofruar produkte ose shërbime miqësore me mjedisin ose përmes një procesi miqësor me mjedisin, me ndihmën e teknologjive të pastra që zvogëlojnë çdo efekt negativ të biznesit.

## 3. Qëllimi dhe Objektivat

### 3.1 Qëllimi i Skemës së Grantit

*Qëllimi* është të krijojë mundësi të reja ekonomike për sipërmarrësit aspirantë dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-ve), bazuar në një skemë granti, e cila mbështet zhvillimin e iniciativave ekonomike lokale, duke ruajtur një qasje miqësore ndaj mjedisit. Kjo skemë granti ka për qëllim të stimulojë rritjen dhe zhvillimin e bizneseve lokale dhe në të njëjtën kohë promovimin e praktikave të qëndrueshme mjedisore.

### 3.2 Objektivat e Skemës së Granteve

- Të krijojë një model transparent dhe të bazuar në projekte konkrete për mbështetjen e bizneseve.



- Të ndërgjegjësojë dhe nxisë të rinjtë shkodranë që të angazhohen në veprimtari ekonomike lokale.
- Të mbështesë krijimin dhe zgjerimin e bizneseve duke përdorur teknologjitë dhe praktikat që kanë impakt pozitiv në mjedis.
- Të përmirësojë aftësitë e nevojshme rreth planifikimit të biznesit dhe menaxhimit financiar, që të jenë të suksesshëm në krijimin dhe zgjerimin e bizneseve të tyre.

### 3.3 Përfitimet e Skemës së Granteve

Kjo Skemë financimi, që po zbatohet për herë të parë në Bashkinë Shkodër, do të nxisë krijimin e bizneseve të gjelbërta, të cilat janë mjaft të rëndësishme për shoqëritë prodhuese, të shëndetshme dhe të qëndrueshme. Këto biznese mund të luajnë një rol kryesor në luftën kundër ndryshimit të klimës dhe kontribuojnë në rritjen dhe krijimin e vendeve të punës.

Nga ana tjetër skema do të përmirësojë më tej bashkëpunimin ndërmjet bashkisë dhe bizneseve lokale.

Përfitimet e biznesit të gjelbër përfshijnë hyrjen në tregjet e pashfrytëzuara, përmirësojnë efikasitetin e burimeve, kursim të kostove dhe përmirësojnë produktivitetin e stafit, si rezultat i një ambienti pune më të pastër dhe më të sigurt.

#### Disa nga përfitimet e një biznesi Eko-Inovativ:

**Qasja në tregje** - duke qenë se klientët gjithnjë e më shumë kërkojnë produkte miqësore me mjedisin për shkak të rritjes së vetëdijes eko, por edhe për arsye shëndetësore (siguri më e madhe të produkteve jo toksike) ose arsye financiare (kosto më e ulët operative).

**Çmime konkurruese** - nga reduktimi i kostove të prodhimit, pasi konsumi i ujit, i energjisë dhe faturat e tjera zvogëlohen dhe përdorimi i burimeve bëhet më efikas. Një biznes që zvogëlon kostot e tij materiale, kostot e energjisë, kostot e ujit si dhe kostot e tjera bëhet më efikas, më pak i kushtueshëm dhe më produktiv.

**Qasja në mbështetje financiare ashtu edhe jo-financiare** - pasi qeveritë i kushtojnë rëndësi gjithnjë e më të madhe sjelljes ndaj mjedisit.

**Fuqi punëtore më e motivuar** - aftësia e secilës për të punuar nuk rrezikohet nga rreziqe shëndetësore siç janë toksinat në vendin e punës, pra është më e sigurtë dhe e mbrojtur në aspektin shëndetësor. Punëtorët në një biznes të gjelbër zakonisht do të kenë më pak probleme shëndetësore dhe do të jenë gjithashtu më produktivë sesa ato në biznese, të cilat përfshihen në procese që përdorin kimikate toksike dhe që dëmtojnë mjedisin.

**Një mjedis rrethues më i shëndetshëm** - në të cilin ruhen burimet e nevojshme nga biznesi për të tashmen dhe të ardhmen. Duke gjelbëruar bizneset e tyre, sipërmarrësit kontribuojnë në mirëmbajtjen e një mjedisi në të cilin ata mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre me një bazë fitimprurëse afatgjatë edhe në të ardhmen.

### 3.5 Përfituesit e skemës së grantit:

**Sipërmarrësit Aspirantë:** Individë që kanë ide për të filluar një biznes të ri dhe kërkojnë mbështetje për të realizuar këto ide.

***Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM):*** Biznese ekzistuese që kërkojnë të zgjerohen, të modernizohen ose të implementojnë praktika të qëndrueshme miqësore me mjedisin.



## UDHËZUESI APLIKIMIT

### “Krijimi i një skeme garancie për bizneset eko inovative për të rinjtë, nëpërmjet mbështetjes financiare me grante”

Ky udhëzues përfshin të gjitha procedurat dhe dokumentacionin e detajuar të nevojshëm për të zbatuar në mënyrë profesionale dhe transparente skemën e grantit. Udhëzuesi bazohet në nenin 28 pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak Shkodër nr.55, datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe Programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024 – 2026, të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar; Vendimit të Kryetarit të Bashkisë Shkodër nr.398, datë 24.4.2024 “Për miratimin e rialokimit të fondit të shpenzimeve brenda të njëjtit program si dhe fish projekti P04130.Q1.O3.A4, “Skemë granti për të rinjtë të buxhetit të vitit 2024 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar; kërkesës nr.14670. prot, datë 11.07.2027 drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, me objekt: ‘Njoftim për ndihmën shtetërore për projektin Krijimi i një skemë garancie për bizneset inovative për të rinjtë, nëpërmjet mbështetjes financiare me grante; “Shkresës së Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr.10491/2. prot, datë 22.08.2024 me objekt: “Komunikohet vendimi i Komisionit të Ndihmës Shtetërore. Sa më sipër merr iniciativën e hartimit të këtij udhëzuesi për zbatimin e dhënies së Granteve për ide dhe biznese eko - inovative për të rinjtë.

#### 1. Çfarë është Granti për “Bizneset Eko - Inovative”?

Granti për bizneset e vogla apo të mesme inovative është një aktivitet i Bashkisë Shkodër, i financuar nga burime publike (të parashikuara në zërin e buxhetit të Bashkisë Shkodër të vitit 2024 në Programin 04130 “Mbështetje për zhvillimin Ekonomik”, i projektuar për të mbështetur financiarisht (Grant) bizneset e reja, të cilat bazohen në një model eko-miqësor, ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese ekologjike, duke futur elementin “e gjelbër”.

Kjo skemë granti është hartuar për t’i shërbyer individëve/sipërmarrësve aspirantë, por edhe bizneseve të vogla dhe të mesme ekzistuese.

*Projekti synon të mbështesë financiarisht kategoritë si më poshtë:*

- Individë/sipërmarrës aspirantë që synojnë të prodhojnë produkte ekologjike miqësore, ofrojnë shërbime ose shfrytëzojnë procese që janë miqësore me mjedisin;
- Biznese ekzistuese me një qasje eko-miqësore;
- Biznese që kthejnë produktet e mbeturinave në materiale dhe energji të përdorshme;
- Biznese që shfrytëzojnë burime natyrore në komunitet;
- Biznese të tilla si agrobiznes (prodhim, përpunim, tregtim) nëse përdorin praktikën e qëndrueshme të bujqësisë dhe i shesin prodhimet e tyre në nivel lokal;
- Biznese që përdorin materiale të ricikluara ose përdorin energji të rinovueshme ose të gjelbër në prodhimin e saj ose produkte që janë 100% të riciklueshme;
- Biznese me ide inovative në krahasim me bizneset e tjera, të cilët dalin me zgjidhje të reja për të adresuar problemet mjedisore;



## 2. Mbështetja financiare

Fondi total i Skemës së Granteve është **4.600.000 lekë**, dhe financohet plotësisht nga Bashkia Shkodër.

**Granti për aplikim:** Aplikimet që plotësojnë kriteret e kësaj skeme janë ato që kërkojnë një buxhet deri në 800 000 lekë.

Granti do të mbështesë **të rinjtë e moshës 18- 30 vjeç, banues në Bashkinë Shkodër, të cilët kanë një ide apo kanë një biznes ekzistues të vogël ose të mesëm dhe kërkojnë të shndërrohen në biznese eko-inovative**, për një projekt propozim me afat nga **6 - 9 muaj** dhe shuma do shpërndahet në bazë të planit financiar të aplikimeve fituese.

- Skema e grantit mbulon 80% të shpenzimeve të pranueshme brenda limitit të sipërpërmendur, ndërsa pjesa tjetër duhet të mbulohet nga vetë aplikuesi në masën 20% të vlerës së projektit. Bashkëfinancimi mund të jetë nga burime alternative ose financime të tjera nga institucione financiare<sup>1</sup>.
- Grantet e alokuara në këtë thirrje mund të mbulojnë shpenzimet e personelit deri në masën 20% të shumës së kërkuar. Ndërsa, 80% e totalit të grantit duhet të shpenzohen për aktivitetet e përfituesit, nga të cilat deri në 10% e kësaj shume mund të përdoret për qëllime reklamash.
- Granti nuk mund të jepet më shumë se një herë për të njëjtën sipërmarrje, brenda 2 viteve. Pra nëse një biznes zgjidhet fitues dhe financohet, ai/ajo nuk mund të aplikojnë në thirrjen që do të shpallet në vitin pasardhës nga Bashkia Shkodër.
- Efektet financiare për zbatimin e këtij aktiviteti do të përballohen nga buxheti i miratuar për Bashkinë Shkodër.
- Bashkia ka të drejtën për të mos ndarë të gjitha fondet në dispozicion nëse projekt-propozimet që nuk i përmbushin kriteret e kërkuara.
- Aplikantët e përzgjedhur mund të planifikojnë financim tjetër shtesë duke përdorur instrumente financiare (kredi, hua, grante, etj.) të disponueshme në Shqipëri nëpërmjet institucioneve financiare ose projekteve të financuara nga donatorë të tjerë, ose me financat e tyre. Në të gjitha rastet e mësipërme, financimi shtesë duhet të deklarohet bashkë me burimin e financimit. Financimi shtesë duhet të përdoret së bashku me asistencën e grantit për fillimin e planit të biznesit, prandaj burimi i financimit duhet të përfshihet në planin e biznesit dhe do të jetë subjekt i vlerësimit.
- Nëse instrumenti financiar do të përdoret për zgjerim të mëtejshëm të biznesit, kjo mbështetje shtesë e përfituar pritet që vetëm të raportohet në vizitat dhe

<sup>1</sup> Bashkëfinancimi mund të jetë nga burime alternative ose financime të tjera nga institucione financiare, por mund të shprehet me kontribut në natyrë (in-kind), që mund të jenë paga, vlerë qeraje ambjenti (për bizneset ekzistuese), vlerë pajisjesh ekzistuese, etj. **Shembull:** Nëse vlera totale e projektit do të jetë 700,000 lekë, atëherë 80% = 560,000 lekë do të financohen nga skema e granteve dhe 140,000 lekë nga aplikanti. Nëse vlera totale e projektit do të jetë 1,000,000 lekë, atëherë 80% = 800,000 lekë do të financohen nga skema e granteve dhe 200,000 lekë nga aplikanti. Nëse vlera totale e projektit do të jetë 1,200,000 lekë, maksimumi që mund të kërkonte nga skema e granteve është 800,000 lekë, dhe pjesa tjetër duhet të financohet nga aplikanti.



raportet e monitorimit.

- Shpenzimet e parakryera nuk do të njihen si investim por vetëm shpenzimet pas nënshkrimit të kontratës së grantit janë të vlefshme.
- Përfituesit e fondeve nuk janë të autorizuar për kalimin e tyre tek palë të treta. Të gjithë detajet specifike mbi kohën dhe pagesat do të përcaktohen në marrëveshjen kontraktuale të grantit në përputhje me projektin dhe specifikat e tij.

### 3. Aplikantët e pranueshëm

Aplikantët e pranueshëm të Skemës janë të gjithë individët, shtetas shqiptarë me moshë 18 – 30 vjeç, banorë të Bashkisë Shkodër, të cilët kanë një ide për të krijuar një biznes eko inovativ, i cili do të zbatohet në territorin e Bashkisë Shkodër.

Çdo aplikant mund të marrë pjesë me vetëm një ide biznesi për çdo thirrje. Nëse shpallet fitues, ai nuk mund të aplikojë vitin pasardhës.

Aplikimet nga bizneset e reja do të pranohen nëse plotësohen kriteret e sipërpërmendura dhe nëse aplikuesi:

1. Është i regjistruar dhe është banor në Shkodër;
2. Është i ri/ e re e moshës 18- 30 vjeç;
3. Nuk është në likuidim, falimentim apo procedurë për mbyllje;
4. Ka paguar të gjitha detyrimet ndaj tatimeve si dhe taksat dhe tarifat vendore;
5. Është i gatshëm të regjistrojë biznesin e tij/saj në Shkodër brenda 15 ditëve para nënshkrimit të kontratës me Bashkinë Shkodër (në rastin e individëve).

#### 3.1 Aplikantë jo të pranueshëm

Aplikantët që nuk përmbushin kriteret për t'u përzgjedhur janë ata, të cilët kanë një konflikt interesi me palët e përfshira në skemë.

Gjithashtu, nuk pranohen ata aplikues që kanë përfituar grante nga Bashkia Shkodër dhe nuk kanë mbyllur me sukses kontratën përkatëse.

Aplikantët, ideja e biznesit e të cilëve nuk përmban një qasje ose proces eko -inovativ për zhvillimin e biznesit.

### 4. Likuidimi i shpenzimeve

Pagesa e grantit të miratuar bëhet me transfertë bankare. Bashkia e Shkodrës do të kryejë likuidimin e vlerës së kontratës, sipas realizimit të planit të aktiviteteve të përcaktuar në projekt, përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së kësaj kontrate nga fondi i parashikuar në buxhetin e vitit 2024 – 2025 të Bashkisë Shkodër.

Levrimi i shumës do të bëhet sipas planit të aktiviteteve. Kusht për levrimitin e një shume është realizimi i shpenzimeve dhe dorëzimi i dokumentacionit mbështetës narrativ dhe financiar, dhe verifikimit të tij nga Bashkia Shkodër për shpenzime që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me aktivitetet e biznesit, sipas pikës 5.1 për periudhën kohore nga nënshkrimi i kësaj kontrate deri në përfundim të saj.

## **5. Shpenzimet që mund të mbulohen nga skema**

### **5.1 Shpenzimet e pranueshme nga skema**

Shpenzimet e njohura që mund të mbulohen nga paratë e grantit duhet të përdoren për zbatimin e planit të biznesit dhe mund të përfshijnë:

- Blerjen e makinerive, mjeteve dhe pajisjeve, si edhe software dhe asete të tjera jo të prekshme të cilat do të shërbejnë për të diversifikuar prodhimin me produkte të reja ose një ndryshim rrënjësor në procesin e përgjithshëm të prodhimit të këtyre produkteve;
- Shpenzime për asete të tjera të paprekshme (liçenca, markim dhe patentim produktesh);
- Krijimi i një faqeje interneti ose publikimi ose reklamimi i aktiviteteve vetëm për 3 (tre) muajt e parë të fillimit dhe nuk mund të tejkalojë më shumë se 10% të grantit total (si për njësitë e reja ekonomike edhe për ato ekzistuese);
- Pagat dhe sigurimet do të mbulohen vetëm për të punësuarit që lidhen drejtpërdrejtë me procesin e prodhimit të produkteve/shërbimeve, deri në 3 muajt e parë nga fillimi i aktivitetit të biznesit, por pa tejkaluar më shumë se 20% të grantit.

### **5.2 Shpenzime që nuk mbulohen nga skema**

Shpenzimet që nuk mund të mbulohen nga paratë e grantit përfshijnë:

- shpenzimet e lindura/krijuara përpara nënshkrimit të kontratës së grantit;
- mirëmbajtje dhe riparime;
- vlera e qerasë së ambjentit;
- blerjen e pasurive të patundshme (tokë, godina, etj.);
- blerjen e mjeteve të transportit;
- çdo shpenzim që nuk lidhet me biznesin e propozuar;
- zbavitje dhe dhurata.

## **6. Mbulimi gjeografik**

Skema e dhënies së Granteve do të zbatohet në territorin e Bashkisë Shkodër.

## **7. Strukturat e skemës së Grantit dhe detyrat e tyre**

Skema e grantit do të zbatohet nga Bashkia Shkodër, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik. Në këtë aktivitet do të përfshihen në disa hapa konkretë të zbatimit dhe struktura të tjera të Bashkisë Shkodër, sipas fushës së thirrjes, në çdo rast Drejtoritë përgjegjëse do të përcaktohen në Urdhërin e grupit të punës për organizimin dhe manxhimin e shpalljes së thirrjes.

Skema do të zbatohet nga strukturat e mëposhtme:

- Komisioni i Vlerësimit
- Koordinatori i Skemës/ Sekretari i Komisionit
- Ekspertët/mentorë për monitorim

- Grupi i monitorimit për zbatimin, certifikimin, pranimin e shpenzimeve.

## 8. Mënyra e procedimit të skemës së grantit

“Skema e grantit”, do të zbatohet në një cikël që ndjek gjashtë hapat e mëposhtëm:

- Shpallja e thirrjes dhe zhvillimi i një fushate informuese.
- Ofrimi i trajnimeve për shkrimin e aplikimeve të suksesshme.
- Përzgjedhja e aplikimeve fituese;
- Kontraktimi dhe përdorimi i fondeve;
- Mentorimi i bizneseve të shpallura fituese;
- Monitorimi dhe vlerësimi.

### 8.1 Shpallja e grantit dhe dorëzimi i aplikimeve

Thirrja për shprehjen e interesit është shpallur në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër me datë 31.10.2024 dhe do të qendrojë e hapur deri me datë 10.12.2024, në orën 16.00.

Një fushatë informuese do të organizohet gjatë kohëzgjatjes së thirrjes, me qëllim njohjen e aplikuesve të mundshëm me kriteret e kësaj skeme, mënyrën e aplikimit, etj.

**Takimet informuese** do të organizohen në ambjentet e Qendrës Rinore Publike “Atelie” për të transmetuar informacionin e nevojshëm të të gjithë aplikantët në një mënyrë të standardizuar dhe të njëjtë. Synimi i këtyre takimeve do të jetë shpërndarja e informacionit të aplikantët e mundshëm të pranueshëm që në të kundërt do të kenë akses të kufizuar të kanalet formale të komunikimit.

Takimet informuese do të organizohen gjatë dy javëve të para të fushatës. Duke përdorur një qasje hap pas hapi, aplikantët informohen për kushtet e përgjithshme të skemës, procedurat e aplikimit dhe kriteret e pranueshmërisë.

Shpallja e skemës së grantit do të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër dhe do të përmbajë:

- Formularin e Aplikimit për Grantin;
- Planin e Biznesit dhe të Financimit sipas modelit të kërkuar ( certifikime/patenta , të tjera dokumenta suportues, të cilat do të vërtetojnë për bizneset ekzistente dhe start up elementin eko miqësor);

Dokumentacioni shtesë duhet të përmbajë sa më poshtë:

- Formularin e vetëdeklarimit;
- Kopjen e kartës së identitetit;
- Kopjen e ekstraktit të biznesit nga regjistri tregtar të lëshuar nga QKB për bizneset ekzistuese (nga e-albania);
- Të gjithë aplikantët (individë) që synojnë të hapin një biznes të ri, kanë afat 15 ditë pas aprovimit të Grantit nga Komisioni i Aprovimit të Grantit dhe firmosjes së Kontratës për regjistrimin e biznesit të tyre pranë zyrave të QKB;
- Vërtetim origjinal për llogari bankare në lekë për bizneset ekzistuese. Bizneset e reja do të sjellin llogarinë bankare pasi të jenë shpallur fitues dhe të jenë regjistruar në



QKB.

- Vërtetim nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore nëse aplikanti nuk ka detyrime financiare ndaj këtij institucioni (për aplikantët të cilët kanë biznes ekzistues).
- Vërtetim për saktësim adrese.

Të gjithë aplikantët duhet t'i qëndrojnë në mënyrë rigoroze formatit të aplikimit dhe formateve të bashkëngjitura në këtë udhëzim.

## 8.2 Pjesëmarrja në trajnim, zhvillim, dhe paraqitja e planeve të biznesit

### Përshkrimi i trajnimit

Të gjithë të rinjtë e interesuar do të kenë mundësinë të marrin pjesë në një kurs trajnimi për planifikimin e biznesit të organizuar nga Bashkia Shkodër. Aplikantët do të trajnohen njëkohësisht përpara mbylljes së thirrjes dhe individualisht gjatë zbatimit të aplikimit. Trajnuesit dhe mjediset për trajnim do të vihen në dispozicion nga Bashkia. Gjithashtu gjatë zbatimit të projektit, aplikantët mund të konsultohen me trajnuesit për planet e tyre të biznesit. Trajnimi do të përqendrohet në mënyrën se si të hartohet një plan biznesi për Thirrjen dhe duhet të përdorë *Formatin e Planit të Biznesit* për ushtrime praktike dhe në mënyrën se si duhet të zbatohet ai.

Të gjitha datat e takimeve informuese, njoftimet dhe materialet e tjera do të publikohen në faqen e Bashkisë Shkodër.

### 8.3 Dorëzimi i aplikimeve

Aplikimet e plotësuara me të gjithë dokumentacionin e detyrueshëm duhet të dorëzohen pranë sportelit të Z1N, në Bashki në tre (3) kopje të printuara dhe një kopje elektronike (në CD ose USB) dorazi, në një zarf të vulosur mbi të cilin është shkruar emri i thirrjes publike ***Formular aplikimi për pjesëmarrjen në skemën e granteve për biznese inovative për të rinjtë***, emri i plotë dhe adresa e aplikantit.

Afati i dorëzimit të aplikimeve është **dita e martë, datë 10 dhjetor 2024 deri në orën 16:00**, dhe gjatë ditëve të punës (e hënë deri në të premte), midis orës 08:00 dhe 16:00, në adresën:

**Bashkia Shkodër**  
**Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1**  
**4001, Shkodër**

Aplikimet e dërguara në mënyra tjera (p.sh. me postë, faks apo e-mail) ose që janë dërguar në adresë tjera nuk do të merren parasysh.

**Çdo aplikim i marrë pas datës përmbyllëse të shpallur do të konsiderohet i pavlefshëm.**

Aplikimet pranohen sipas procedurave të mëposhtme:

- Një verifikim formal i adresës, kryhet në sportelin e Z1N, dokumentet të cila nuk kanë adresë, nuk do të pranohen;
- Çdo kandidati i caktohet një numër reference me datën dhe orën e dorëzimit.

## 8.4 Shpallja e rezultateve

Në çdo rast, nëse projekt-propozimet e tyre miratohen për financim apo jo, të gjithë aplikantëve u njoftohet me shkrim vendimi për projekt-propozimin e tyre deri me datë 16 dhjetor 2024. Rezultatet shpallen në faqen e internetit të Bashkisë Shkodër.

## 8.5 Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikimeve

Secili anëtar i Komisionit do të vlerësojë secilën ide biznes individualisht si më poshtë. Aplikimet do të vlerësohen në bazë të:

(1) Kushteve administrative:

- Aplikimi është i kompletuar sipas kërkesave të thirrjes.
- Dokumentacioni është dorëzuar në 3 kopje të shtypura dhe në një kopje elektronike (CD apo USB).

(2) Kushtet që kanë të bëjnë me Aplikuesin dhe aktivitetet:

- Konfirmimi se aplikuesi, dhe aktivitetet i përmbushin kushtet e specifikuar në Udhëzuesin për Aplikime.

(3) Vlerësimi i cilësisë së aplikimit dhe vlerësimi i planit të biznesit dhe të dhënave financiare:

Vlerësimi i aplikimeve do të bëhen në përputhje me kriteret e specifikuar në Tabelën Vlerësuese që është pjesë përbërëse e këtij dokumenti. Ka tre lloje të kriterëve vlerësues: kriteret idesë së biznesit, kriteret e planit të biznesit dhe të financimit dhe kriteret e dokumentacionit shtesë për trajnimet apo njohjen e tregut.

Ju lutemi kushtoni vëmendje informacionit në vijim:

Kriteret e pikëzimit ndahen në seksione dhe nën-seksione. **Çdo nën-seksion duhet vlerësuar me pikët e përcaktuara nga 1 në 5 sipas mënyrës së mëposhtme: 1 = shumë i keq; 2 = i keq; 3 = i përshtatshëm; 4 = i mirë; 5 = shumë i mirë.** Çdo anëtar i komisionit plotëson një tabelë individuale vlerësimi dhe të gjithë anëtarët nënshkruajnë tabelën përmbledhëse të vlerësimit të aplikimeve. Renditja e aplikimeve bëhet duke u nisur nga aplikimi me numrin më të madh të pikëve, i ndjekur nga aplikimi pasardhës me më pak pikë.

### **Shënim për Seksionin 1. Zhvillimi i idesë së Biznesit**

Projekti përjashtohet nga procesi i mëtejshëm i vlerësimit në rast se numri total i pikëve në Seksionin 1 është më i ulët se 25 pikë, sepse aplikimi i dorëzuar nuk garanton cilësinë e aplikimit.

### **Shënim për Seksionin 2. Kriteret e Planit të Biznesit dhe Financimit**

Projekti përjashtohet nga shqyrtimi i mëtejshëm në rast se numri total i pikëve në Seksionin 2 është më i ulët se 35 pikë, sepse pikët tregojnë se megjithëse aplikanti garanton cilësinë e aplikimit, aplikimi nuk ofron një analizë të mirëfilltë financiare dhe plani i biznesit nuk është relevant.

## **8.6 Ankesat.**

Pas botimit zyrtar të rezultateve, aplikuesit kanë të drejtë të ankimojnë rezultatin brenda *pesë ditësh punë* nga marrja e njoftimit. Të gjitha ankimimet e paraqitura brenda afatit përfundimtar shqyrtohen nga Komisioni i Vlerësimit, që duhet të informojë aplikantin për vendimin dhe përfundimet e tyre me shkrim brenda *pesë ditësh punë*.

Koordinatori i skemës do të kontaktojë me e-mail ose telefon të gjithë aplikantët për t'i njoftuar me rezultatet e vlerësimit. Nëse gjatë procesit të vlerësimit konstatohet se dokumentet e aplikantit janë të rreme, këta aplikantë do të përjashtohen menjëherë.

Pikët përfundimtare për secilën ide biznesi janë mesatarja e pikëve të anëtarëve të Komisionit.

Së fundi, Komisioni rendit aplikantët sipas pikëve përfundimtare të secilës ide biznesi në rendin zbritës (nga aplikanti me pikët më të larta te ai me pikët më të ulëta). (Aplikantet me 70 pikë e lart do të përzgjidhen).

## **8.7 Kushtet rreth zbatimit të projektit pas miratimit të grantit.**

Pas marrjes së vendimit për miratimin e grantit, aplikanti që ka pasur sukses në aplikim do të ofrohet një kontratë për zbatimin e projektit. Para se të nënshkruajë kontratën dhe nëse është e nevojshme, Bashkia Shkodër ka të drejtën ti kërkojë subjektit aplikues modifikime të caktuara në projekt (buxhet dhe planin e biznesit) për ta harmonizuar atë me rregullat dhe procedurat e zbatimit të projektit, pa cenuar thelbin e projekt propozimit.

